



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1645/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit KUR “Mitrovica” sh.a, me seli në Rr.”Bislim Bajgora” p.nr ne Mitrovicë, ndaj debitorit Komuna Skënderaj me seli ne rr. ”28 Nëntori” pn, në Skënderaj, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.358/2023 datë 29.09.2023, me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e kreditorit KUR “Mitrovica” sh.a, me seli në rr.”Bislim Bajgora” p.nr ne Mitrovicë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.358/2023 i datës 29.09.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

REFUZOHET prapësimi i debitorit Komuna Skënderaj me seli në Skënderaj, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.3323/2020 datës 17.09.2020, si i pa bazuar, MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.3323/2020 i datës 17.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa me seli në Mitrovicë.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.358/2023 dt.29.09.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna Skënderaj me seli ne rr. ”28 Nëntori” pn, dhe ka Anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.3323/2020 dt.17.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, me seli ne Mitrovicë, si dhe ka përfunduar ne tërësi procedurën në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e kreditorit si te bazuar, aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe urdhrin përmbartimor ta lë ne fuqi.

Përgjigje ndaj ankesës se kreditorit ka ushtruar debitori, duke pretenduar se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbartimi nuk e ka cilësinë e përmbartueshmërisë, propozon qe gjykata ta aprovoj aktvendimin e atakuar dhe ankesën e kreditorit ta refuzoj.

Dhomat e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori KUR “Mitrovica” sh.a, me seli ne rr.”Bislim Bajgora” p.nr ne Mitrovicë, me datën 17.09.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Komuna Skenderaj me seli ne rr.”28 Nëntori” pn, ne Skenderaj, në bazë të faturës code:S-57 si dokument i besueshëm

Përmbartuesi Privat Atip Mustafa nga Mitrovica, sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin përmbartimor P.nr.3323/20 dt.17.09.2020, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të borxhit për shfrytëzimin e ujësjellësit dhe shërbimeve të kanalizimit, kreditorit të paguaj shumën prej 9,518.50 euro, me kamatë prej 8% nga data e paraqitjes së propozimit e deri të pagesa definitive, në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij urdhri.

Kundër urdhrit përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se si Komunë nuk jemi kompetent për këtë çështje sepse gabimisht ky propozim i është drejtuar Komunës së Skënderajt sepse menaxhues dhe shfrytëzues është vet Stadiumi “Bajram Aliu” dhe klubet sportive janë ato të cilat shfrytëzojnë dhe janë përgjegjës për të gjitha shpenzimet e krijuara. Fatura mbi të cilën është mbështetur propozimi për përmbartim nuk e ka cilësinë e përmbartueshmërisë dhe nuk përmbush kushtet e një dokumenti të besueshëm, më tutje thekson se kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit në kuptim të nenit 71 par.1 nenpar.1.4 të LPP dhe nenit 360 par.1.1 të LMD. Propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta shfuqizoj propozimin për përmbartim dhe ta refuzoj propozimin e kreditorit për përmbartim.

Ndaj prapësimin të debitorit, kreditori ka ushtruar përgjigje, me arsyetimin se debitori për pretendimet e veta është dashur të na bëjë vendimin se nuk e shfrytëzon më këtë pronë, sa i përket parashkrimit kreditori arsyeton se nuk kemi të bëjmë me parashkrim dhe s’kemi të bëjmë me nenin 360 të LMD-së, sepse Komuna nuk është person fizik ose amvisëri por kemi të bëjmë me person juridik.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar me të cilin ka vendosur më definitivisht si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetimin të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka gjetur se ekstrakti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi përmbart të dhënat për debitorin dhe kreditorin por i mungon koha e përmbartjes së detyrimit monetar. Gjykata i referohet nenit 29 par.1, par.2 dhe par.3 të LPP-së, dhe arsyeton se në mungesë të kohës së përmbartjes kreditori ka mundësinë ligjore të paraqes deklaratë me shkrim para organit të përmbartimit me të cilin tregon kohën se kur është bërë e arritshme kërkesa e tij, e që në rastin konkret mungojnë dy format e përcaktimit të kohës së përmbartjes së kërkesës. Më tej arsyeton se si rezultat i mungesës së kohës së përmbartjes vjen deri të mungesa e tipareve të përmbartueshmërisë së dokumentit të besueshëm dhe për pasojë duhet të zbatohet neni 71 par.1 nenpar.1.1 të LPP. Gjykata shton se në seancën e datës 24.05.2022 debitori nuk kishte dërguar përfaqësuesin e tij edhe pse ishte ftuar me rregull, ndërsa ka analizuar edhe pretendimet e kreditorit por gjeti se

te njëjtat nuk janë relevante për një vendosje tjetër andaj edhe ka vendosur si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik te gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar ne kuptim te dispozitës se nenit 29 par.1, 2 dhe par.3 et LPP si dhe nenit 71 par.1 pika 1.1 e LPP-së, edhe pse i ka përdorë si bazë që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime te drejta në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat ne lëndë, e mbi te cilat mund të iniciohet procedura e përmbarimit.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar drejtë me vlerësimin se dokumenti mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi nuk mund te pranohet si dokument i besueshëm dhe se i njëjti nuk ka tipare te përmbarueshmerisë.

Kjo gjykatë vlerëson se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist te kontabilitetit me shifrën S-57 është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim konform dispozitave te nenit 21 dhe nenit 29 par.1 nenpar.1.2 te LPP. Ky ekstrakt plotëson kushtet ligjore te parapara me nenin 29 par.3 te LPP i cili përcakton se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”* dhe se një dokument për të shërbyer si dokument i besueshëm patjetër duhet të përmbaj elementet e përcaktuara me ketë nen për te qenë i përshtatshëm për ekzekutim. Këto kushte nga ky nen duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej tyre e bënë dokumentin përkatës të papërshtatshëm për përmbarim. Marrë parasysh këto te lartcekura, Dhoma e shkallës së dytë konstaton faktin se ekstrakti mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi konsiderohet si dokument i ekzekutueshëm sepse përmban periudhën kohore për te cilën kërkohet përmbushja e detyrimit nga kreditori si edhe te dhënat tjera sa i përket debitorit dhe kreditorit, adresën, përshkrimin e faturimit, inkasimit si dhe numrin e faturave, ndërsa sa i përket kohës së përmbushjes së detyrimit, kjo gjykatë vlerëson se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se dokumenti ne rastin konkret ekstrakti nuk përmban kohën e përmbushjes së detyrimit dhe se kreditori nuk ka paraqitur deklaratë me shkrim para organit te përmbarimor, është i paqëndrueshëm me vet faktin se elementet nga neni 29 par.3 te LPP-ë, e ne këtë rast edhe afati i përmbushjes se detyrimit është konsumuar nga kreditori me propozimin për përmbarim.

Pra, ne lidhje me këtë çështje Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se kredia e kreditorit është bërë e kërkueshme sepse kreditori në petitum te propozimit për përmbarim kërkon nga debitori, që në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të urdhrin përmbarimor të bëjë përmbushjen e borxhit për shumën e detyrimit prej 9,518.50 euro. Nga kjo rezulton se kredia e kreditorit ndaj

debitorit është bërë e kërkueshme me paraqitjen e këtij propozimi dhe precizimit të afatit parativ prej 7 ditësh, e si rrjedhojë e kësaj rezulton se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi i plotëson të gjitha kushtet, për të qenë dokument i përshtatshëm për përmbarim.

Dhomat e shkallës së dytë nuk i pranoi pretendimet e debitorit se borxhi është parashkruar në bazë të nenit 360 par.1 nenp.1.1 të LMD-së, sepse afati njëvjeçar i parashkrimit, që e parasheh kjo dispozitë ligjore përfshihet në rastet kur kemi të bëjmë me shërbime për nevojat shtëpiake, ndërsa në rastin konkret borxhi rrjedh nga kontrata komerciale ku debitor është organi publik, dhe afati i parashkrimit prej 3 vite parashihet me nenin 355 të LMD-së, prandaj duke marrë parasysh periudhën e borxhit të kërkuar dhe datën e propozimit të përmbarimit 17.09.2020, kjo gjykatë vlerësoi se nuk ka përshkrim të borxhit.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.3323.2020 dt.17.09.2020 nga ana e Përmbaruesit Privat Atip Mustafa - Mitrovicë.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1645/23 me datë 07.05.2024

Gjyqtari

Krenar Berisha